



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 68 prot.

Kamëz, më 20 05 .2024

V E N D I M  
Nr. 53 .Datë 20 05 2024  
M B I

**“DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR DJEGIE DHE PËRMBYTJE  
BANESE”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 20.05.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.41 Datë 16.05.2024 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ; Ligji, Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” ; VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” ; Urdhërave të Kryetarit të Bashkisë nr.353, datë 09.04.2024 ; nr.354, datë 09.04.2024 ; nr.394, datë 24.04.2024 ; për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve në banesa, relacionit të hartuar nga administrata e Bashkisë, në zbatim të urdhërave, dhe V.K.B. Kamëz Nr. 103, datë 18.12.2023 “Për miratimin e detajuar të buxhetit për vitin 2024 dhe planit të buxhetit për vitet 2024 ; 2025, dhe 2026, struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

- Miratimin e dhënies së ndihmës financiare për djegie dhe përmbytje banese të :  
z. Demir Dali Xhika, për banesën e dëmtuar nga zjarri datës 02.04.2024;  
z. Xhemal Nezir Shehi për banesën e dëmtuar nga zjarri datës 05.04.2024;  
z. Elton Xhemal Cenaliu për banesën e dëmtuar nga përmbytja datës 17.04.2024.
- Miratimin e dokumentacionit tekniko – ligjorë hartuar në formën e kriterëve në relacion, sipas preventivave të komisionit të vlerësimit të dëmeve hartuar nga administrata e Bashkisë Kamëz, në zbatim të Urdhërave të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dëmtimeve të shkaktuara në banesën e z. ”.
- Të akordohet një ndihmë financiare për këto familje sipas tabelës më poshtë:

| Nr | Emër Atësi Mbiemër | Vlera e dëmit<br>lekë | Për pagesë, 50% e vlerës në<br>lekë, sipas VKM-së nr. 329,<br>dt. 16.05.2012 |
|----|--------------------|-----------------------|--|
| 1  |                    | 544,098               | 272,049  |
| 2  |                    | 226,000               | 113,000  |
| 3  |                    | 305,773               | 152,886  |
|    | <b>TOTALI</b>      | <b>1,075,871</b>      | <b>537,935</b>   |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

4. Ndihma financiare për familjet e dëmtuara përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”*.
5. Kjo shumë prej 537,935 (pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëtëqind e tridhjetë e pesë ) lekë të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë**.

KRYETAR KËSHILLI  
Hysen KOLDASHI